



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Nr.1

2006

24 janar

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.6, datë 13.1.2006	Për miratimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosta-Rikës, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të shërbimit.....	3
Vendim i KM nr.7, datë 13.1.2006	Për miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Qipros, për asistencën e ndërsjellë administrative, për zbatimin e saktë të legjislacionit doganor dhe për parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore.....	5
Vendim i KM nr.9, datë 13.1.2006	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Kolsh të qarkut të Lezhës.....	13
Vendim i KM nr.10, datë 13.1.2006	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Fan të qarkut të Lezhës.....	14
Vendim i KM nr.11, datë 13.1.2006	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë Rrëshen të qarkut të Lezhës.....	14
Vendim i KM nr.12, datë 13.1.2006	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në bashkinë Bajram Curri të qarkut të Kukësit....	15

Vendim i KM nr.13, datë 13.1.2006	Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, në komunën Dajç të qarkut të Shkodrës.....	15
Vendim i KM nr.14, datë 13.1.2006	Për ndryshimin dhe kalimin e përgjegjësisë së administrimit të një objekti të portit të peshkimit, Shëngjin, nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, Ministrisë së Brendshme.....	16
Vendim i KM nr.15, datë 13.1.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.429, datë 30.8.1993 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin e Komitetit Qeveritar të Bisedimit të Borxhit të Jashtëm”, të ndryshuar.....	17
Vendim i KM nr.16, datë 13.1.2006	Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.730, datë 6.11.2003 të Këshillit të Ministrave “Për funksionimin e Këshillit Kombëtar të Punës dhe për caktimin e përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave në këtë këshill”.....	17
Vendim i KM nr.17, datë 13.1.2006	Për miratimin e afateve të përdorimit të armëve, të teknikës e të pajisjeve të Forcave të Armatosura dhe të rregullave për trajtimin e tyre pas heqjes nga armatimi dhe përdorimi.....	18
Vendim i KM nr.18, datë 13.1.2006	Për përbërjen, funksionimin dhe mënyrën e shpërblimit të Komisionit Kombëtar Kundër Dhunës në Sport.....	24
Vendim i KM nr.20, datë 13.1.2006	Për një ndryshim në vendimin nr.726, datë 23.11.2005 “Për shpronësimin për interes publik të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, të cilat preken nga ndërtimi i segmentit rrugor Qafë-Kashar-Rinas”.....	25
Vendim i GJK nr.1, datë 16.1.2006	Me objekt shfuqizimin e vendimeve nr.1104, datë 19.09.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; nr.186, datë 04.05.2004 të Gjykatës së Apelit Gjyrokastër dhe nr.2142, datë 24.12.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, si të papajtueshme me Kushtetutën.....	25
Vendim i ERE nr.1, datë 11.1.2006	Për transferimin e licencës nga shoqëria “Korsel“ sh.p.k. te shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k.....	29
Vendim i ERE nr.2, datë 11.1.2006	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....	30
Vendim i ERE nr.3, datë 11.1.2006	Për fillimin e procedurave të shqyrtimit.....	30

VENDIM
Nr. 6, datë 13.1.2006

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES ME SHKËMBIM NOTASH, NDËRMJET
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
KOSTA RIKËS, PËR HEQJEN E VIZAVE PËR MBAJTËSIT E PASAPORTAVE
DIPLOMATIKE ZYRTARE DHE TË SHËRBIMIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes me shkëmbim notash, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosta-Rikës, për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të shërbimit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Zoti Ministër,

Kam nderin t’i drejtohem Shkëlqesisë Suaj, në kuadër të përfundimit të “Marrëveshjes për heqjen e vizave për mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të shërbimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Kosta-Rikës dhe të konfirmojë marrjen e notës së Shkëlqesisë Suaj, Ref. DVM-149-05, datë 19 gusht 2005, e cila citon si më poshtë:

“Zoti Ministër,

Kam kënaqësinë t’i drejtohem Shkëlqesisë Suaj, duke iu referuar negociatave të ndërmarra që kanë të bëjnë me heqjen e vizave nga pasaportat diplomatike, zyrtare dhe të shërbimit të lëshuara nga qeveritë tona, në kuadër të forcimit të marrëdhënieve tona dypalëshe, duke lehtësuar reciprokisht hyrjen, daljen dhe lëvizjet e funksionarëve të tyre.

Sa më lart, Qeveria e Kosta Rikës dëshiron t’i propozojë Qeverisë së Nderuar të Republikës së Shqipërisë, Marrëveshjen për heqjen e vizave në pasaportat diplomatike, zyrtare dhe të shërbimit.

Neni 1

1. Shtetasit kostarikenë dhe ata shqiptarë, mbajtës të pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të shërbimit, janë të përjashtuar nga viza e hyrjes, daljes apo e qëndrimit në territorin shqiptar ose atë kostariken përkatësisht.

2. Pas hyrjes, mbajtësit e pasaportave të sipërpërmendura mund të qëndrojnë në territorin e palëve për një periudhë jo më të gjatë se tre muaj (90 ditë).

3. Me kalimin e këtij afati, nëse mbajtësit e pasaportave të përmendura dëshirojnë të zgjasin qëndrimin e tyre në njërin prej dy vendeve, ose dëshirojnë të zhvillojnë aktivitete fitimprurëse, duhet të kryejnë formalitetet përkatëse të lejes së qëndrimit sipas ligjit, pranë instancave administrative dhe juridike përkatëse në përputhje me rregullat në fuqi.

Shkëlqesisë së tij

Zoti Marko Vinicio Vargas Pereira

Ministër a.i.i Punëve të Jashtme dhe Kulteve

Neni 2

1. Shtetasit kostarikenë dhe ata shqiptarë, mbajtës të pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të shërbimit, që bëjnë pjesë në një mision diplomatik, konsullor ose organizëm ndërkombëtar, të akredituar në territoret e palëve, janë të përjashtuar nga viza e hyrjes, qëndrimit ose e daljes lirisht nga vendi në të cilin kryejnë shërbime, gjatë kohës së detyrës së tyre.

2. Kjo dispozitë do të zbatohet gjithashtu, për familjarët e personave të përmendur në paragrafin e mëparshëm, gjithmonë kur kanë të përbashkët me ta, të njëjtin vend banimi dhe janë mbajtës të pasaportave diplomatike, zyrtare apo të shërbimit.

Neni 3

Hyrja dhe dalja e shtetasve kostarikenë dhe atyre shqiptarë, mbajtës të pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të shërbimit, në territoret e vendeve përkatëse, duhet të kryhet në pikat e kontrollit të autoriteteve përkatëse të migracionit për qytetarët e huaj.

Neni 4

1. Kjo marrëveshje nuk i përjashton mbajtësit e pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të shërbimit të palëve, nga respektimi i ligjeve dhe i rregullave në fuqi që kanë të bëjnë me hyrjen, qëndrimin dhe daljen nga vendet përkatëse.

2. Në të njëjtën kohë, kjo Marrëveshje rezervon të drejtën që të refuzojë hyrjen ose të ndalojë qëndrimin e mbajtësve të pasaportave diplomatike dhe të shërbimit të palëve në territoret e tyre përkatëse, nëse ata kanë cenuar legjislacionin e vendit, në territorin e të cilit kanë hyrë.

3. Palët duhet të komunikojnë reciprokisht dhe pa vonesë, me rrugën përkatëse diplomatike, çdo modifikim në legjislacionin në fuqi lidhur me aspektet e rregulluara me anë të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 5

1. Të dyja palët do të shkëmbejnë në rrugë diplomatike modelet e pasaportave diplomatike, zyrtare dhe të shërbimit të përmendura në këtë Marrëveshje, brenda tridhjetë (30) ditëve para hyrjes në fuqi të saj.

2. Në rastin kur çdonjëra nga palët do të lëshojë një model të ri pasaporte ose do t'u bëjë ndryshime medeleve të shkëmbyera, duhet t'i bëjë të ditura këto ndryshime në rrugë diplomatike, gjashtëdhjetë (60) ditë më parë nga data e hyrjes në fuqi të modeleve të reja apo ndryshimeve.

Neni 6

Ndryshimi i kësaj Marrëveshjeje mund të kryhet me pëlqimin e palëve. Kjo Marrëveshje do të shtohet nëpërmjet protokolleve të veçanta, të cilat përbëjnë pjesën themelore të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 7

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi tridhjetë (30) ditë pas marrjes së njoftimit të fundit, nëpërmjet të cilit palët të kenë informuar në rrugë diplomatike se kanë përmbushur të gjitha kërkesat e nevojshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje ka një periudhë vlefshmërie të pakufizuar.

3. Secila nga palët mund të pezullojë plotësisht ose pjesërisht zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Ndërprerja ose rizbatimi i kësaj Marrëveshjeje do t'i komunikohet palës tjetër në rrugë diplomatike dhe do të hyjë në fuqi ditën e dorëzimit të këtij njoftimi palës tjetër.

Secila prej palëve mund ta denoncojë këtë Marrëveshje nëpërmjet njoftimit paraprak të dërguar në rrugë diplomatike. Në këtë rast, denoncimi do të hyjë në fuqi nëntëdhjetë (90) ditë pas datës së njoftimit të palës tjetër.

Në rastë se Qeveria e Republikës së Shqipërisë do të jetë dakord me propozimin e mësipërm kjo notë dhe nota e përgjigjes së Shkëlqesisë Suaj, ku të shprehet pëlqimi i qeverisë suaj, do të përbëjnë një marrëveshje mes qeverive tona, që do të hyjë në fuqi datën e vendosur në të.

Përfitoj nga rasti për t'i përsëritur Shkëlqesisë Suaj sigurimet e konsideratës dhe vlerësimit tim të lartë.”

Kam nderin të pranoj, në emër të Qeverisë së Republikës të Shqipërisë, propozimin e parashikuar në notën e mësipërme dhe shprehem dakord që nota e Shkëlqesisë Suaj dhe kjo notë në përgjigje të saj, të përbëjnë një marrëveshje ndërmjet dy qeverive, e cila do të hyjë në fuqi sipas parashikimit të bërë në Marrëveshje.

Nëpërmjet kësaj note përfitoj nga rasti për t'i konfirmuar Shkëlqesisë Suaj konsideratat e mia më të larta.

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Besnik Mustafaj

VENDIM
Nr. 7, datë 13.1.2006

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË QIPROS, PËR ASISTENCËN E NDËRSJELLË ADMINISTRATIVE, PËR ZBATIMIN E SAKTË TË LEGJISLACIONIT DOGANOR DHE PËR PARANDALIMIN, HETIMIN DHE LUFTËN NDAJ SHKELJEVE DOGANORE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr.8371, datë 9.7.1998 “Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare”, me propozimin e Ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Qipros, për asistencën e ndërsjellë administrative, për zbatimin e saktë të legjislacionit doganor dhe për parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

MARRËVESHJE

NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË QIPROS, MBI ASISTENCËN E NDËRSJELLË ADMINISTRATIVE, PËR ZBATIMIN E SAKTË TË LEGJISLACIONIT DOGANOR DHE PËR PARANDALIMIN, HETIMIN DHE LUFTËN NDAJ SHKELJEVE DOGANORE

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Qipros, këtej e tutje referuar si Palët Kontraktuese,

duke konsideruar se shkeljet ndaj legjislacionit doganor janë të dëmshme për interesat e tyre ekonomike, tregtare, fiskale, shoqërore dhe kulturore;

duke konsideruar rëndësinë e përcaktimit të saktë të detyrimeve doganore dhe të taksave të tjera të grumbulluara gjatë importit apo eksportit, si dhe sigurimin e ushtrimit të duhur të masave mbi ndalimin, kufizimin dhe kontrollin;

duke njohur nevojën për bashkëpunimin ndërkombëtar në çështjet lidhur me zbatimin dhe ushtrimin e legjislacionit doganor;

të bindur se aksionet kundër shkeljeve doganore mund të bëhen më efektive nëpërmjet bashkëpunimit të ngushtë ndërmjet administratave të tyre doganore, bazuar në dispozita të qarta ligjore;

duke marrë në konsideratë instrumentet përkatëse të Këshillit të Kooperimit Doganor (njohur si Organizata Botërore Doganore), në veçanti rekomadimet mbi asistencën e ndërsjellë doganore të 5 dhjetorit 1953;

duke marrë në konsideratë gjithashtu konventat ndërkombëtare detyruese për të dyja palët dhe që përmbajnë ndalime, kufizime dhe masa speciale kontrolli lidhur me mallra specifike, ranë dakord për sa më poshtë vijon

KAPITULLI I PËRKUFIZIME

Neni 1

Për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje:

1. “Shpërndarje e kontrolluar” do të thotë metoda e lejimit të lëndëve narkotike apo substancave psikotrope ose substancave të përdorura zakonisht për prodhimin e paligjshëm të lëndëve narkotike ose substancave psikotrope për të kaluar nga, nëpër apo për në territorin e një apo më shumë vendeve me njohurinë dhe nën vëzhgimin e autoriteteve kompetente me synim identifikimin e personave të përfshirë në kryerjen e shkeljeve;
2. “Administratë doganore” do të thotë në Republikën e Shqipërisë- Drejtoria e Përgjithshme e Doganave e Ministrisë së Financave dhe në Republikën e Qipros- Departamenti i Doganave dhe Akcizave;
3. “Detyrimet dhe taksat doganore” do të thotë detyrimet, taksat dhe të tjera, të cilat grumbullohen gjatë apo në lidhje me importimin apo eksportimin e mallrave;
4. “Legjislacioni doganor” do të thotë dispozitat rregullatore dhe statutore lidhur me grumbullimin e detyrimeve dhe taksave doganore dhe mbi importimin, eksportimin, lëvizjen dhe magazinimin e mallrave, administrimi dhe ushtrimi i të cilave i është ngarkuar specifikisht doganës, si dhe rregullore të tjera të nxjerra nga doganat sipas fuqive të tyre statuale;
5. “Shkelje doganore” do të thotë çdo shkelje apo përpjekje për shkelje të legjislacionit doganor;
6. “Informacion” do të thotë çdo e dhënë, dokumente, raporte, kopje të certifikuara dhe autentifikuara të këtyre, si dhe komunikime të tjera;

7. "Inteligjencë" do të thotë informacion i cili është përpunuar edhe/ose analizuar për të mundësuar një tregues të lidhur me shkeljet doganore;
8. "Person" do të thotë si një person fizik ashtu edhe një person juridik;
9. "Të dhëna personale" do të thotë të dhënat lidhur me një qenie njerëzore të indentifikuar apo të indentifikueshëm;
10. "Administratë kërkuese" do të thotë administratë doganore që kërkon asistencë;
11. "Administratë e kërkuar" do të thotë administrata doganore nga e cila kërkohet asistencë.

KAPITULLI II FUSHËMBULIMI I MARRËVESHJES

Neni 2

1. Palët Kontraktuese nëpërmjet administratave të tyre doganore do t'i mundësojnë njëra-tjetrës asistencë administrative sipas kushteve të vendosura në këtë Marrëveshje, për zbatimin e saktë të legjislacionit doganor dhe për parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore.
2. E gjithë asistenca, sipas kësaj Marrëveshjeje, nga secila prej Palëve Kontraktuese do të jepet në përputhje me dispozitat e veta kombëtare konstitucionale, ligjore dhe administrative dhe brenda limiteve të kompetencave dhe resurseve të mundshme të administratës së vet doganore.
3. Kjo Marrëveshje synon vetëm asistencën e ndërsjellë administrative ndërmjet Palëve Kontraktuese; dispozitat e kësaj Marrëveshjeje nuk do t'i japin mundësi një personi privat për të marrë, shkelur ose hequr ndonjë evidencë apo të pengojë ekzekutimin e një kërkesë.
4. Çdo kërkesë për arrestim të ndonjë personi, si dhe për mbledhjen dhe grumbullimin me forcë të detyrimeve doganore, taksave të tjera, gjobave dhe detyrimeve të tjera do të përjashtohet nga një asistencë e tillë.

KAPITULLI III FUSHËMBULIMI I ASISTENCËS

Neni 3

1. Administratat doganore do t'i mundësojnë njëra-tjetrës, sipas kërkesës pas me iniciativën e vet, informacion dhe inteligjencë që ndihmon në sigurimin e aplikimit të duhur të legjislacionit doganor dhe parandalimin, hetimin dhe luftën ndaj shkeljeve doganore.
2. Secila administratë doganore, gjatë bërjes së kërkimeve për llogari të administratës tjetër doganore, do të veprojë si të ishte duke i bërë këto kërkime për llogari të vet ose sipas kërkesës së një autoriteti tjetër në atë Palë Kontraktuese.

Neni 4

1. Sipas kërkesës, administrata e kërkuar do të mundësojë të gjithë informacionin mbi legjislacionin doganor dhe procedurat e aplikuara në atë Palë Kontraktuese dhe të lidhura me kërkimet që kanë të bëjnë me një shkelje doganore.
2. Secila administratë doganore do të komunikojë, sipas një kërkesë apo me iniciativë të vet, çdo informacion të mundshëm lidhur me:
 - a) teknika të reja doganore antikontrabandë, të cilat kanë treguar efektivitetin e vet;
 - b) tendenca, metoda apo mjete të reja të përdorura në kryerjen e shkeljeve doganore.

KAPITULLI IV LLOJE TË VEÇANTA ASISTENCE

Neni 5

Sipas kërkesës, administrata e kërkuar do t'i mundësojë në veçanti administratës kërkuese informacionin e mëposhtëm:

a) nëse mallrat e eksportuara që janë importuar në territorin doganor të Palës Kontraktuese Kërkuese, janë eksportuar ligjërisht nga territori doganor i Palës Kontraktuese të Kërkuar;

b) nëse mallrat që janë eksportuar nga territori doganor i Palës Kontraktuese Kërkuese, janë importuar ligjërisht në territorin doganor të Palës Kontraktuese të Kërkuar, si dhe procedurat doganore, nëse ka, nën të cilat janë vendosur këto mallra.

Neni 6

Sipas një kërkesë, administrata e kërkuar do të mundësojë informacion dhe inteligjencë dhe do të mbajë survejim special mbi:

a) mallrat në transport apo magazinim të njoftuara nga Pala Kontraktuese se japin shkak për të dyshuar mbi një trafik të paligjshëm drejt territorit doganor të Palës Kontraktuese Kërkuese;

b) mjete transporti të dyshuara nga administrata kërkuese se janë përdorur për të kryer një shkelje doganore në territorin doganor të njëres prej Palëve Kontraktuese;

c) vende të dyshuara nga administrata kërkuese se janë përdorur për kryerjen e një shkeljeje doganore në territorin doganor të njëres prej Palëve Kontraktuese.

Neni 7

1. Administratat doganore do t'i mundësojnë njëra-tjetrës, sipas kërkesës apo me iniciativën e vet, informacion apo inteligjencë mbi transaksionet e kryera apo të planifikuara, të cilat përbëjnë apo duket se përbëjnë një shkelje doganore.

2. Në rastet serioze, të cilat mund të përfshijnë një dëm thelbësor për ekonominë, shëndetin publik, sigurinë publike ose çdo interes vital të një Pale Kontraktuese, administrata doganore e Palës tjetër Kontraktuese, sa herë të jetë e mundur, do të dërgojë informacion dhe inteligjencë me iniciativën e vet.

Neni 8

Administratat doganore:

a) do të asistojnë njëra-tjetrën në respekt të ekzekutimit të masave dhe procedimeve, duke përfshirë pezullimin dhe kapjen e mallrave;

b) do të vënë në dispozicion mallrat e konfiskuara apo të ardhurat nga shitja e tyre si rezultat i asistencës së mundësuar nga kjo Marrëveshje, në përputhje me dispozitat ligjore të Palës Kontraktuese në kontroll të mallrave apo të ardhurave.

Shpërndarja e kontrolluar

Neni 9

1. Kushtëzuar nga legjislacioni kombëtar i shteteve të Palëve Kontraktuese, administratat e tyre doganore, sipas nevojës, do të bashkëpunojnë në kontekstin e shpërndarjes ndërkombëtare të kontrolluar të lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope ose substancave të përdorura vazhdimisht për prodhimin e lëndëve narkotike apo substancave psikotrope.

2. Ngarkesat, për të cilat do të kryhet shpërndarja e kontrolluar, mundet, me marrëveshje reciproke ndërmjet administratave doganore, të interceptohen dhe të lejohen të vazhdojnë udhëtimin e tyre të paprekura ose me mallrat e përmendura në paragrafin 1 të hequra, apo tërësisht ose pjesërisht të zëvendësuara.

3. Shpërndarja e kontrolluar do të vendoset në bazën e rast pas rasti. Këto vendime mund të përfshijnë gjithashtu rregullime financiare dhe mirëkuptime ndërmjet administratave doganore.

Antikitete dhe thesare artistike e kulturore

Neni 10

1. Administrata doganore e secilës prej Palëve Kontraktuese, me iniciativë të vet ose sipas kërkesës, do t'i mundësojë administratës doganore të Palës tjetër Kontraktuese, çdo informacion të mundshëm mbi aktivitetet që përfshijnë kontrabandën e antikiteteve dhe thesareve artistike dhe kulturore, ose mbi personat që janë të përfshirë në arkitivete të tilla.

2. Administrata doganore e secilës prej Palëve Kontraktuese, sipas kërkesës së administratës doganore të Palës tjetër Kontraktuese, do të monitorojë për një periudhë të caktuar kohore lëvizjen e mallrave të përshkruara në paragrafin 1 të këtij neni, si dhe personave të përfshirë dhe mjeteve të transportit të përdorura.

KAPITULLI V

INFORMACIONI DHE INTELIGJENCA

Neni 11

1. Informacioni origjinal do të kërkohet vetëm në rastet kur kopjet e autentifikuara apo certifikuara janë të pamjaftueshme, dhe do të kthehen, sa më shpejt të jetë e mundur, të drejtat e administratës së kërkuar apo të palëve të treta lidhur me to do të mbeten të paprekura.

2. Çdo informacion dhe inteligjencë që do të shkëmbehet sipas kësaj Marrëveshjeje, do të shoqërohet nga i gjithë informacioni i nevojshëm për interpretimin ose shfrytëzimin e tij.

KAPITULLI VI

EKSPERTËT DHE DËSHMITARËT

Neni 12

Sipas kërkesës, administrata e kërkuar mund t'i autorizojë punonjësit e vet, nëse ata pranojnë, për t'u paraqitur para një gjykate në Palën tjetër Kontraktuese si ekspertë apo dëshmitarë në një çështje, lidhur me një shkelje doganore.

KAPITULLI VII

KOMUNIKIMI I KËRKESËS

Neni 13

1. Asistenca sipas kësaj kërkesë do të shkëmbehet direkt ndërmjet administratave doganore.

2. Kërkesat për asistencë sipas kësaj Marrëveshjeje do të bëhen me shkrim dhe do të shoqërohen nga çdo dokument që konsiderohet i dobishëm. Kur situatat e kërkojnë, kërkesat mund të bëhen gjithashtu me gojë. Këto kërkesa do të konfirmohen menjëherë me shkrim.

3. Kërkesat e bëra në përputhje me paragrafin 2 të këtij neni, do të përfshijnë detajet e mëposhtme:

- a) administratën që bën kërkesën;
- b) thelbin dhe shkakun për kërkesë;
- c) një përshkrim të përmbledhur të çështjes, elementet ligjore dhe natyrën e procedimit;

d) emrat dhe adresat e palëve të përfshira në proces, nëse njihen.

4. Një kërkesë nga secila prej Palëve Kontraktuese se duhet ndjekur një procedurë e caktuar, duhet të jetë në përshatje me dispozitat administrative dhe ligjet kombëtare të Palës Kontraktuese të Kërkuar.

5. Informacioni dhe inteligjenca e përmendur në këtë Marrëveshje do t'u komunikohet punonjësve të caktuar specifikisht për këtë qëllim nga secila administratë doganore. Një listë e punonjësve të caktuar për këtë qëllim do të shkëmbehet nga administratat doganore të Palëve Kontraktuese, në përputhje me paragrafin 2 të nenit 18 të kësaj Marrëveshjeje.

KAPITULLI VIII EKZEKUTIMI I KËRKESAVE

Neni 14

1. Nëse administrata e kërkuar nuk e ka informacionin e kërkuar, ajo, në përputhje me dispozitat e veta administrative dhe legjislacionin kombëtar:

- a) do të fillojë kërkime për ta gjetur këtë informacion;
- b) menjëherë, do t'ua transmetojë kërkesën autoriteteve përgjegjëse;
- c) do të informojë mbi autoritetet e përshtashme përgjegjëse.

2. Çdo kërkim sipas paragrafit 1 të këtij neni mund të përfshijë marrjen e deklaratave nga personat nga të cilët është marrë informacioni në lidhje me një shkelje doganore, si dhe nga dëshmitarë apo ekspertë.

Neni 15

1. Sipas një kërkesë me shkrim, punonjësit e caktuar specifikisht nga administrata kërkuese, me autorizimin e administratës së kërkuar dhe kushtëzuar nga kushtet që kjo e fundit mund të vendosë, me qëllim investigimin e një shkeljeje doganore:

- a) mund të shqyrtojnë në zyrat e administratës së kërkuar dokumentet, regjistrat dhe të dhënat e tjera të nevojshme për të nxjerrë informacion lidhur me atë shkelje doganore;
- b) mund të marrin kopje të dokumenteve, regjistrave dhe të dhënave të tjera lidhur me atë shkelje doganore;
- c) mund të jenë prezent gjatë një kërkimi të kryer nga administrata e kërkuar në territorin doganor të Palës Kontraktuese të Kërkuar dhe që ka lidhje me administratën kërkuese.

2. Kur punonjësit e administratës kërkuese janë prezent në territorin e Palës tjetër Kontraktuese sipas situatave të përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, ata në çdo kohë duhet të jenë të aftë të japin prova të statusit të tyre zyrtar.

3. Ndërkohë që janë aty, ata do të gëzojnë të njëjtën mbrojtje si ajo që u jepet punonjësve doganorë së Palës tjetër Kontraktuese, në përputhje me ligjet në fuqi aty, dhe do të jenë përgjegjës për ndonjë shkelje që mund të kryejnë.

KAPITULLI IX KONFIDENCIALITETI I INFORMACIONIT

Neni 16

1. Çdo informacion apo inteligjencë e marrë në kuadrin e asistencës administrative sipas kësaj Marrëveshjeje do të përdoret vetëm për qëllimet e kësaj Marrëveshjeje dhe nga administratat doganore, me përjashtim të rasteve kur administrata doganore që ka dërguar informacionin ka miratuar shprehimisht përdorimin e tij për qëllime të tjera apo nga autoritete të tjera.

2. Çdo informacion apo inteligjencë e marrë sipas kësaj Marrëveshjeje do të trajtohet si konfidencial dhe do të gëzojë të paktën të njëjtën mbrojtje dhe konfidencialitet siç gëzon i njëjti lloj informacioni apo inteligjence sipas legjislacionit kombëtar të Palës Kontraktuese që e ka marrë.

Neni 17

Kur shkëmbehen të dhëna personale nën këtë Marrëveshje, Palët Kontraktuese do të sigurojnë një standard të mbrojtjes së të dhënave të paktën ekuivalent me atë që rezulton nga zbatimi i parimeve në aneksin e kësaj Marrëveshjeje, i cili përbën një pjesë integrale të kësaj Marrëveshjeje.

KAPITULLI X PËRJASHTIME

Neni 18

1. Në rastet kur asistenca sipas kësaj Marrëveshjeje do të shkelte sovranitetin, sigurinë, politikat publike ose interesat e tjera thelbësore kombëtare të një Pale Kontraktuese, ose mund të përfshinte një shkelje të sekretit profesional, tregtar apo industrial, ose mund të binte ndesh me legjislacionin kombëtar apo dispozitat administrative, asistenca mund të refuzohet.

2. Nëse administrata kërkuese do ta kishte të pamundur të përgjigjej nëse një kërkesë e ngjashme do të ishte bërë nga administrata e kërkuar, ajo do të tërheqë vëmendjen për këtë faktor në kërkesën e vet. Përgjigjja ndaj një kërkesë e tillë do të varet nga administrata e kërkuar.

3. Asistenca mund të shtyhet nga administrata e kërkuar mbi faktin se ajo mund të ndërhyjë në një investigim në vazhdim, proces apo gjykim. Në një rast të tillë, administrata e kërkuar do të konsultohet me administratën kërkuese për të përcaktuar nëse asistenca mund të jepet në bazë të këtyre termave apo kushteve që mund të kërkojë administrata e kërkuar.

4. Kur asistenca mohohet apo shtyhet, duhet të paraqiten shkaqet për mohimin apo shtyrjen.

KAPITULLI XI KOSTOT

Neni 19

1. Administratat doganore do të heqin dorë nga të gjitha pretendimet për rimbursimin e kostove të dala gjatë ekzekutimit të kësaj Marrëveshjeje, përveç shpenzimeve dhe dietave paguar ekspertëve dhe dëshmitarëve, si dhe kostot e përkthyesve dhe interpretuesve që nuk janë punonjës qeveritarë, këto do të mbulohen nga administrata kërkuese.

2. Nëse ka apo kërkohen shpenzime të një natyre thelbësore apo të jashtëzakoshme për ekzekutimin e kërkesës, Palët Kontraktuese do të konsultohen për të përcaktuar termat dhe kushtet sipas të cilave do të ekzekutohet kërkesa, si dhe mënyrën sesi do të përballohen shpenzimet.

KAPITULLI XII ZBATIMI I MARRËVESHJES

Neni 20

1. Administratat doganore do të marrin masa në mënyrë që punonjësit e tyre përgjegjës për investigimin apo luftën ndaj shkeljeve doganore të mbajnë lidhje direkte dhe personale me njëri-tjetrin.

2. Administratat doganore do të vendosin mbi rregullimet e detajuara për lehtësimin e zbatimit të kësaj Marrëveshjeje.

3. Administratat doganore do të përpiqen të zgjidhin me marrëveshje reciproke çdo problem apo dyshim të dalë nga interpretimi apo zbatimi i kësaj Marrëveshjeje.

4. Konfliktet për të cilat nuk është gjetur zgjedhje, do të zgjidhen nëpërmjet kanaleve diplomatike.

KAPITULLI XIII
ZBATIMI

Neni 21

Kjo Marrëveshje do të zbatohet në territoret doganore Të të dyja Palëve Kontraktuese, siç përcaktohet në dispozitat e tyre kombëtare konstitucionale, ligjore dhe administrative.

KAPITULLI XIV
HYRJA NË FUQI DHE PËRFUNDIMI

Neni 22

Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi në ditën e parë të muajit të dytë, pasi Palët Kontraktuese të kenë njoftuar njëra-tjetrën me shkrim nëpërmjet kanaleve diplomatike se kërkesat konstitucionale apo të brendshme për hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje janë plotësuar.

Neni 23

1. Kjo Marrëveshje është parashikuar për një kohëzgjatje të pakufizuar, por secila nga Palët Kontraktuese mund ta përfundojë atë në çdo kohë me anë të njoftimit nëpërmjet kanaleve diplomatike.

2. Përfundimi do të ketë efekt tre muaj nga data e dërgimit të njoftimit të denoncimit të Pala tjetër Kontraktuese. Procedimet në vazhdim në kohën e përfundimit do të kompletohen detyrimisht në përputhje me dispozitat e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 24

Palët Kontraktuese do të takohen me qëllim rishikimin e kësaj Marrëveshjeje sipas kërkesës ose në fund të pesë vjetëve nga data e hyjes së saj në fuqi, nëse nuk njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim se një rishikim i tillë është i panevojshëm.

Dëshmitarë për sa më sipër të poshtëshënuarit, të autorizuar përkatësisht, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Kryer në Nikozia, më datë 28.6.2005 në dy kopje në gjuhët shqip, greqisht dhe anglisht, ku të gjitha janë njësoj autentike. Në rast divergjencash, teksti në anglisht do të mbizotërojë.

ANEKSI
PARIMET BAZË TË MBROJTJES SË TË DHËNAVE

1. Të dhënat personale që i nënshtrohen përpunimit automatik:

- a) do të merren dhe përpunohen ndershmërisht dhe ligjërisht;
- b) do të storojnë për qëllime të specifikuar dhe të ligjshme dhe nuk do të përdoren në një mënyrë të papërshtatshme me ato qëllime;
- c) do të jenë adekuate, të lidhura dhe pa tejkaluar lidhjen me qëllimin për të cilin janë stuaruar;

- d) do të jenë të sakta dhe, kur është e nevojshme, të rifreskuara;
- e) do të ruhen në një formë që lejon identifikimin e subjektit të të dhënave për jo më shumë se sa kërkohet nga qëllimi për të cilin janë stuaruar të dhënat.

2. Të dhënat personale që zbulojnë origjinën racore, opinionet politike, besimin fetar, si dhe besime të tjera, si dhe të dhënat personale lidhur me jetën shëndetësore apo seksuale, nuk mund të përpunohen në mënyrë automatike, me përjashtim të rasteve ku legjislativi kombëtar mundëson mbrojtjen e saktë. E njëjta gjë do të aplikohet për të dhëna personale që kanë të bëjnë me dënime kriminale.

3. Do të ndërmerren masat e duhura të sigurisë për mbrojtjen e të dhënave personale të storuara në dosje të dhënash automatike kundër shkatërrimit të paautorizuar ose humbjes aksidentale, si dhe kundër aksesit, ndryshimit apo shpërndarjes së paautorizuar.

4. Çdo person duhet të ketë mundësi:

a) të përcaktojë ekzistencën e një dosjeje të dhënash personale të automatizuar, qëllimin e saj kryesor, si dhe identitetin dhe rezidencën e banesës ose vendin kryesor të punës së kontrolluesit të dosjes.

b) të përfitojë në intervale të arsyeshme dhe pa vonesa të tejjzgjatura apo shpenzime, konfirmim nëse të dhëna personale lidhur me të janë stuar në dosjen e automatizuar të të dhënave, si dhe komunikimin ndaj tij e këtyre të dhënave në formë inteligjente.

c) të përfitojë, sipas rastit fshirjen apo ndryshimin e këtyre të dhënave, nëse ato janë përpunuar në kundërshtim me dispozitat e legjislacionit kombëtar që ka efekt mbi parimet bazë të përcaktuara në parimet 1 dhe 2 të këtij aneksi.

d) të informohet nëse një kërkesë për komunikim ose, sipas rastit, konfirmim, ndryshim apo fshirje siç referohet në paragrafët b dhe c të këtij parimi, nuk është plotësuar.

5.1. Nuk do të lejohen përjashtime në dispozitat sipas parimeve 1, 2 dhe 4 të këtij aneksi, me përjashtim të limiteve të përcaktuara në këtë parim.

5.2. Përjashtime nga dispozitat e parimeve 1, 2 dhe 4 të këtij aneksi do të lejohen kur këto përjashtime mundësohen nga ligji i Palës Kontraktuese dhe përbën një masë të nevojshme në një shoqëri demokratike në interes:

a) të mbrojtjes së sigurisë shtetërore, sigurisë publike, interesave monetare të shtetit apo goditjes së akteve kriminale;

b) të mbrojtjes së subjektit të të dhënave ose të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

5.3. Kufizimet në ushtrimin e të drejtave të specifikuar në parimin 4, paragrafët b, c dhe d të këtij aneksi mund të mundësohen me ligj në respekt të dosjeve të të dhënave personale të automatizuara të përdorura për qëllime kërkimesh statistikore apo shkencore kur aty është e qartë se nuk ka risk të shkeljes së privatësisë së subjektit të të dhënave.

6. Secila Palë Kontraktuese merr përsipër të caktojë sanksionet dhe dënimet e duhura për shkeljet e dispozitave të ligjit kombëtar, të cilat kanë efekt mbi parimet bazë të caktuara në këtë aneks.

7. Asnjë prej dispozitave të këtij aneksi nuk do të interpretohet si kufizues apo që ka efekt mundësinë e një Pale Kontraktuese për t'i dhënë subjektit të të dhënave një masë më të gjerë mbrojtjeje se ajo e përcaktuar në këtë aneks.

VENDIM

Nr. 9, datë 13.1.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, NË KOMUNËN KOLSH, TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrisë së Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Kolsh të qarkut të Lezhës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 33 (tridhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 197 (njëqind e nëntëdhjetë e shtatë).

2. Ndryshimet që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 10, datë 13.1.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, NË KOMUNËN FAN TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Fan të qarkut të Lezhës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 137 (njëqind e tridhjetë e shtatë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 1017 (një mijë e shtatëmbëdhjetë).

2. Ndryshimet që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 11, datë 13.1.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, NË BASHKINË RRËSHEN TË QARKUT TË LEZHËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ në bashkinë Rrëshen të qarkut të Lezhës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 293 (dyqind e nëntëdhjetë e tre) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 2101 (dy mijë e njëqind e një).

2. Ndryshimet që mund t'i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 12, datë 13.1.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, NË BASHKINË BAJRAM CURRI TË QARKUT TË KUKËSIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të bashkisë Bajram Curri të qarkut të Kukësit, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj bashkie.

Lista me 30 (tridhjetë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 157 (njëqind e pesëdhjetë e shtatë).

2. Ndryshimet që mund t’i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 13, datë 13.1.2006

PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
SHTETËRORE, NË KOMUNËN DAJÇ TË QARKUT TË SHKODRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 3 të nenit 8 të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që janë në juridiksionin territorial dhe administrativ të komunës Dajç të qarkut të Shkodrës, sipas propozimit të paraqitur nga këshilli i kësaj komune.

Lista me 32 (tridhjetë e dy) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 143 (njëqind e dyzet e tre).

2. Ndryshimet që mund t’i bëhen listës gjatë periudhës së afishimit, të pasqyrohen në listën përfundimtare të pronave, e cila miratohet nga Këshilli i Ministrave.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 14, datë 13.1.2006

**PËR NDRYSHIMIN DHE KALIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË NJË
OBJEKTI TË PORTIT TË PESHKIMIT, SHËNGJIN, NGA MINISTERIA E MJEDISIT,
PYJEVE DHE ADMINISTRIMIT TË UJËRAVE, MINISTRISË SË BRENDSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15 shkronja “c” të ligjit nr.8743, datë 22.2.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:


1. Objekti “Pjesë e hangarit” e portit të peshkimit në Shëngjin, së bashku me truallin funksional, me sipërfaqe 576 m², në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave, sipas genplanit që i bashkëlidhet këtij vendimi, t’i kalojë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Brendshme.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave të ndjekin procedurat për transferimin e kësaj prone të paluajtshme.

3. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe kryeregjistruesi i pasurive të paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



VENDIM
Nr.15, datë 13.1.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.429, DATË 30.8.1993 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KRIJIMIN E KOMITETIT QEVERTAR TË BISEDIMIT TË
BORXHIT TË JASHTËM”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 1 e vendimit nr.429, datë 30.8.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohet si më poshtë vijon:

1. Komiteti Qeveritar i Bisedimit të Borxhit të Jashtëm, që më poshtë do të quhet “Komiteti”, ka këtë përbërje:

- | | |
|---|------------------|
| - Ministri i Financave | kryetar; |
| - Guvernatori i Bankës së Shqipërisë | zëvendëskryetar; |
| - Ministri i Drejtësisë | anëtar; |
| - Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës | anëtar; |
| - Drejtori i Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit,
në Ministrinë e Financave | anëtar; |
| - Drejtori i Departamentit të Operacioneve Monetare,
në Bankën e Shqipërisë | anëtar; |
| - Ekspert, vendas apo i huaj | anëtar. |
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 16, datë 13.1.2006

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË VENDIMIN NR.730, DATË 6.11.2003 TË
KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR FUNKSIONIMIN E KËSHILLIT KOMBËTAR TË
PUNËS DHE PËR CAKTIMIN E PËRFAQËSUESVE TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE NË
KËTË KËSHILL”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 4, 6 e 9 të nenit 200 të ligjit nr.7961, datë 12.7.1995 “Kodi i Punës së Republikës të Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.730, datë 6.11.2003 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime e shtesa:

1. Paragrafi i parë i pikës 5, ndryshohet, si më poshtë vijon:
“Përfaqësuesit e Këshillit të Ministrave, anëtarë të Këshillit Kombëtar të Punës, janë:
- Ministri i Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta;

- Ministri i Financave;
 - Ministri i Shëndetësisë;
 - Ministri i Arsimit dhe i Shkencës;
 - Ministri i Drejtësisë;
 - Ministri i Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës;
 - Ministri i Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit.”.
2. Në fund të pikës 10, shtohet shkronja “e” me këtë përmbajtje:
“e) Komisioni i Shanseve të Barabarta.”.
3. Në pikën 12, fjalët “...më shumë se 8 anëtarë...”, zëvendësohen me “...jo më shumë se 8 anëtarë...”.
4. Pika 17 ndryshohet, si më poshtë vijon:
“17. Fondi i dhënë nga Buxheti i Shtetit për Këshillin Kombëtar të Punës caktohet si zë i veçantë në buxhetin e Ministrisë së Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta.
Ky fond përdoret kryesisht për:
a) përballimin e shpenzimeve të mbledhjeve të KKP-së;
b) komisionet e specializuara të përhershme të tij;
c) funksionimin e zyrave shtetërore të pajtimit;
ç) organizimin dhe pjesëmarrjen në konferencat tripalëshe;
d) publikime, për të cilat vendos KKP-ja.”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 17, datë 13.1.2006

PËR MIRATIMIN E AFATEVE TË PËRDORIMIT TË ARMËVE, TË TEKNIKËS E TË PAJISJEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA DHE TË RREGULLAVE PËR TRAJTIMIN E TYRE PAS HEQJES NGA ARMATIMI DHE PËRDORIMI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 7 e 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimn e Ministrisë të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e afateve të përdorimit të armëve, mjeteve dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura, sipas tabelave nr.1 dhe nr.2 që i bashkëlidhen këtij vendimi.
2. Në Forcat e Armatosura, arma, mjete ose pajisja të hiqen nga përdorimi me urdhër të autoritetit përkatës sipas pikës 5 të këtij vendimi, kur janë plotësuar:
 - a) vitet e përdorimit, sipas tabelave nr.1 e nr.2;
 - b) kilometrat e përshkruara, sipas tabelës nr.1;
 - c) orët e punës të kryera, sipas tabelës nr.1;
 - ç) numri i të shtënave, të kryera sipas tabelës nr.2.
3. Të gjitha mjetet, pajisjet dhe armatimi, që hiqen nga përdorimi në Forcat e Armatosura, por që kanë vlera përdoruese në gjendjen që janë, lejohen të shiten, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Mjetet, pajisjet dhe armatimi, që hiqen nga përdorimi në forcat e Armatosura, por që nuk mund të shiten si mjete dhe pajisje ushtarake, lejohen t’u nënshtrohen procedurave të asgjësimit, demilitarizimit dhe tjetërsimit të pronës shtetërore.

5. Procedurat dhe përgjegjësitë për heqjen nga përdorimi të armëve, mjeteve dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura janë si më poshtë vijon:

a) Për anijet, avionët, helikopterët dhe raketat tokë-ajër, propozimi për heqjen nga përdorimi të bëhet nga Ministri i Mbrojtjes dhe të miratohet nga Kryeministri;

b) Për armatimin, raketat portative dhe municionet luftarake, mjetet e blinduara, mjetet e transportit dhe sistemet e pajisjet e ndërlidhjes, propozimi për heqjen nga përdorimi të bëhet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe të miratohet nga Ministri i Mbrojtjes;

c) Për pajisjet fushore, makineritë dhe pajisjet e mirëmbajtjes, të komunikimit telefonik, kompjuterike dhe të shëndetësisë, propozimi për heqjen nga përdorimi të bëhet nga komandanti i forcës ose i komandës mbështetëse përkatëse dhe të miratohet nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura.

ç) Për burimet e ushqimit elektrik të ndërlidhjes dhe për të gjitha pajisjet e tjera, që nuk përfshihen në shkronjat “a”, “b”, e “c”, propozimi për heqjen nga përdorimi të bëhet nga komandantët e brigadave/regjimenteve dhe të miratohet nga komandanti i forcës ose i komandës mbështetëse përkatëse.

6. Ministri i Mbrojtjes të paraqesë për miratim në Këshillin e Ministrave afatet e përdorimit për armët, mjetet dhe pajisjet, që përdoren nga Forcat e Armatosura, për të cilat nuk janë miratuar afate përdorimi në tabelat që i bashkëlidhen këtij vendimi.

7. Vendimi nr.617, datë 4.12.2002 i Këshillit të Ministrave “Për heqjen nga armatimi dhe përdorimi të një pjese të armëve, teknikës dhe pajisjeve të Forcave të Armatosura dhe për asgjësimin ose çmontimin dhe shitjen e tyre”, i ndryshuar, zbatohet vetëm për mjetet dhe pajisjet ushtarake, që janë hequr nga përdorimi, sipas tabelave që i bashkëlidhen vendimit të mësipërm.

8. Të ardhurat, që do të realizohen sipas pikës 3 të këtij vendimi, të ndahen përkatësisht:

- 10 për qind Buxhetit të Shtetit;

- 90 për qind Ministrisë së Mbrojtjes, për t’u përdorur për nevojat e modernizimit dhe të ristrukturimit të Forcave të Armatosura.

9. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes të nxjerrë udhëzimin përkatës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Sali Berisha

AFATET E PËRDORIMIT TË ARMËVE, TEKNIKËS DHE PAJISJEVE TË FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Tabela nr.1

PËR MJETET DHE PAJISJET USHTARAKE

I.	Mjete të blinduara	Jetëgjatësia në vite	Jetëgjatësia në kilometra	Jetëgjatësia në orë pune
1.	Transportues i blinduar me zinxhirë (TRBL)	30 vjet		750 moto/orë
2.	Transportues i blinduar me goma	25 vjet		800 moto/orë
3.	Tërheqës	35 vjet		750 moto/orë
4.	Tank model 59	35		750 moto/orë

II.	ANIJE	Jetëgjtësia në vite		
1.	Anije transporti e madhe	40		
2.	Minahedhëse e madhe (MHM)	40		
3.	Gjuajtës detar i madh (GJDM)	40		
4.	Gjuajtës detar i vogël (GJDV)	40		
5.	Katër silurues	40		
6.	Anije patrulluese e madhe (A.65 Foot)	40		
7.	Anije silure kapëse	40		
8.	Kateri i radës	40		
9.	Rimorkiator	40		
10.	Cisternë	40		
11.	Dok lundrues	40		
12.	Motoskaf	25		
13.	Anije polumbare	40		
14.	Motogomë	25		
15.	Motobarkë	25		
III.	MJETET AJRORE	Jetëgjtësia në vite		Jetëgjtësia në orë pune
1.	Avion Uti-Mig-17 (Stërvitje)			4200 orë/pune
2.	II-28 (Bombardues) Stërvitje			7200 orë/pune
3.	Avion Mig-19			3600 orë/pune
4.	Avion Jak			6000 orë/pune
5.	Helikopter AB-205	35		Përcaktohet nga uzina riparuese
6.	Helikopter AB-206	35		Përcaktohet nga uzina riparuese
7.	Avion fotografimi AN-2			4800 orë/pune
IV.	MJETE TRANSPORTI	Jetëgjtësia në vite	Jetëgjtësia në kilometra	Jetëgjtësia në orë pune
1.	Motoçikletë	9	45 000	
2.	Autoveturë komerciale	10	200 000	
3.	Autobus	17	300 000	
4.	Mikrobus	12	240 000	
5.	Autoambulancë komerciale	12	150 000	
6.	Autoveturë rikonicioni	14	220 000	
7.	Autoambulancë taktike	14	140 000	
8.	Kamionçinë	14	210 000	
9.	Kamion i lehtë	18	180 000	
10.	Kamion i mesëm	18	180 000	

11.	Kamion i rëndë	20	270 000	
12.	Rimorkio	20	160 000	
13.	Autobot i mesëm	20	200 000	
14.	Autobot i rëndë	18	180 000	
15.	Rimorkiator	22	220 000	
16.	Kamion vetëshkarkues	18	180 000	
17.	Vinç pirun	20	160 000	
18.	Autovinç	20	200 000	
19.	Buldozer i mesëm me goma	20	120 000	
20.	Buldozer i rëndë me goma	20	160 000	
21.	Buldozer me zinxhirë	20		6000
22.	Eskavatorë dhe mjete dhengarkuese	20		8000
V.	PAJISJET FUSHORE	Jetëgjatësia në vite		Jetëgjatësia në orë pune
1.	Furrë mekanike fushore	17		1000
2.	Karro kuzhina	17		1000
3.	Dushe fushore	10		1000
4.	Lavanteri fushore	10		1000
5.	Gjenerator me benzinë	12		1000
6.	Gjenerator diezel deri 10 Kw	15		2500
7.	Gjenerator diezel mbi 10 Kw	15		5000
8.	Pajisje frigoriferike	15		120 000
9.	Soba gatimi fushore	10		1000
10.	Pajisje për pastrimin e ujit	20		1000
VI.	MAKINERI DHE PAJISJE TË MIRËMBAJTJES			
1.	Makineri dhe pajisje metalprerëse, vënë në punë para 1990	33		
2.	Makineri dhe pajisje metalprerëse, vënë në punë pas 1990	20		
3.	Makineri e pajisje elektronike, vënë në punë para 1990	22		
4.	Makineri e pajisje elektronike, vënë në punë para 1990	17		
5.	Makineri e pajisje përpunim druri, vënë në punë para 1990	22		

6.	Makineri dhe pajisje punim druri, vënë në punë pas 1990	18		
7.	Makineri dhe pajisje (kaldajat), vënë në punë para 1990	16		
8.	Makineri dhe pajisje (kaldajat), vënë në punë pas 1990	13		
9.	Pajisje e instrumente testuese, vënë në punë para 1990	16		
10.	Pajisje e instrumente testuese, vënë në punë pas 1990	12		
11.	Makineri e pajisje teknologjike (elektropompa, elektrovinca, kompresor), vënë në punë para 1990	8		
12.	Makineri e pajisje teknologjike (elektropompa, elektrovinça, kompresor), vënë në punë pas 1990	6		
VII. SISTEMET DHE PAJISJET E NDËRLIDHJES				
a-	Pajisjet e HF në brezin e frekuencës	Jetëgjatësia në vite		Jetëgjatësia në orë pune
1.	RF-5200	20 vjet		
2.	RF-5800	25 vjet		
3.	ANPRS/138	20 vjet		
4.	Radiomodem RF 5710 W, 5710 A	20 vjet		
5.	Fieldeworks	20 vjet		
6.	Ndërfaqës	20 vjet		
7.	Getwey	20 vjet		
8.	Hub taktik	20 vjet		
9.	SSB	25 vjet		
b-	Pajisjet e VHF/UHF në brezin e frekuencës 30-300 MHz			
1.	Rf-5800	20 vjet		
2.	Radiostacion SEM-25	10 vjet		
3.	Radiostacionm SEM 35	10 vjet		
4.	Radiostacion SEM 52	15 vjet		
5.	Radiostacion SEM 70	25 vjet		
6.	Radiostacion SEM 80	25 vjet		
7.	Radiostacion SEM 90	25 vjet		

8.	Radiostacion RT 3600	15 vjet		
9.	Radiostacion VRC	20 vjet		
10.	Radiostacion AN/PRC 77	10 vjet		
11.	Reperditor në brezin e frekuencave (136-174) MHz	20 vjet		
12.	Radio bazë në brezin e frekuencave (136-174) MHz	15 vjet		
13.	Radio Mobil në brezin e frekuencave (136-174) MHz	15 vjet		
14.	Radio dore në brezin e frekuencave (136-174)MHz	10 vjet		
c.	Pajisje radiorele në brezin e frekuencave 70 MHz 38 Ghz			
1.	Radio rele dixhitale	25 vjet		
2.	Radio rele analoge	10 vjet		
ç.	Pajisje të komunikimit telefonik			
1.	Central telefonik elektronik deri në 120 nr.	10 vjet		
2.	Central telefonik elektronik deri në 250 nr.	20 vjet		
3.	Central telefonik elektronik mbi 250 nr.	15 vjet		
4.	Aparat telefonik satelitor	20 vjet		
5.	Aparat telefonik automatik	10 vjet		
6.	Aparat fax	10 vjet		
VIII.	BURIMET E USHQIMIT ELEKTRIK (BUE)	Jetëgjatësia në vite		Jetëgjatësia në orë pune
1.	UPS për personal kompjuter	2-3 vjet		
2.	UPS qendror	20 vjet		
3.	Stabilizator	20 vjet		
4.	Radrizator	20 vjet		
5.	Karikues për pila	10 vjet		
6.	Gjenerator	15 vjet		
IX.	PAJISJET KOMPJUTERIKE	Jetëgjatësia në vite		Jetëgjatësia në orë pune
1.	Personal kompjuter	10 vjet		
2.	Lap Top	10 vjet		
3.	Printer	10 vjet		
4.	Rack	25 vjet		
5.	Koncetrator	10 vjet		
6.	Modem HDSL	5 vjet		

7.	Modem SHDSL	5 vjet		
8.	SEITCH	10 vjet		
9.	Analizator LAN-i	20 vjet		
10.	Router	15 vjet		
11.	Tape Dive	10 vjet		
12.	Skaner	20 vjet		
13.	Server	20 vjet		
14.	Fotokopje	10 vjet		
X.	PAJISJE SHËNDETËSIE			
1.	Kompjuter tomografie	10 vjet		
2.	ECHO	10 vjet		
3.	Aparat rontgeni	15 vjet		

**AFATET E PËRDORIMIT TË ARMËVE, TEKNIKËS DHE PAJISJEVE TË FORCAVE TË
ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Tabela nr.2

Nr.	Arma, teknika dhe pajisja	Jetëgjatësia në vite	Sasia e qitjeve (me regjim zjarri teknik normal)	Jetëgjatësia në orë pune
I	Armatimi			
1	Pistoleta		5 000	
2	Pushkë snajper		7 000	
3	Automatik		12 000	
4	Mitroloz i lehtë		15 000	
5	Mitroloz kompanie		10 000	
6	Mitroloz i rëndë		10 000	
7	Granatëdhënëse e lehtë Kundërtank (GHLKT)		1 000	
8	Mortajë 60 mm		5 000	
9	Mortajë 82 mm		6 000	
10	Top 75 mm		5 000	
11	Pistoleta shenjdhënëse		5 000	
12	Obuz 122 mm		4 500	
13	Top 122 mm		4 500	
14	Top obuz 152 mm		4 500	
15	Mitroloz KA 12.7 mm		9 000	
16	Top KA 37 mm		7 000	
17	Raketë portative (shtrat lëshimi)	10 vjet		
18	Top KA 57 mm		7 000	
19	Raketa tokë-ajër (SAM 2)	25 vjet		

VENDIM
Nr. 18, datë 13.1.2006

**PËR PËRBËRJEN, FUNKSIONIMIN DHE MËNYRËN E SHPËRBLIMIT TË KOMISIONIT
KOMBËTAR KUNDËR DHUNËS NË SPORT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 1, 2 e 4 të nenit 50 të ligjit nr.9376, datë 21.4.2005 “Për sportin”, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Komisioni Kombëtar kundër Dhunës në Sport të kryesohet nga zëvendësministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe në përbërje të ketë:

- | | |
|--|-----------------------|
| - Drejtorin e Sportit në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | sekretar; |
| - Zëvendësministrin e Brendshëm | anëtar; |
| - Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit | anëtar; |
| - Sekretarin e Përgjithshëm të KOSH-it | anëtar; |
| - Sekretarin e Përgjithshëm të Federatës Shqiptare të Futbollit | anëtar; |
| - Kryetarin e Shoqatës së Gazetarëve Sportivë | anëtar; |
| - Një specialist të Drejtorisë së Sportit në Ministrinë e Turizmit Kulturës, Rinisë dhe Sporteve | koordinator/sekretar. |

2. Komisioni Kombëtar kundër Dhunës në Sport të mbledhet nga Ministri i Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve jo më shumë se 4 herë në vit pas njoftimit të bërë nga kryetari. Sekretari i Komisionit përgatit materialet që do të shqyrtohen dhe ia vë në dispozicion anëtarëve të Komisionit 7 ditë përpara mbledhjes. Komisioni i zhvillon mbledhjet kur janë të pranishëm shumica e anëtarëve, pra jo më pak se pesë veta, në të kundërt mbledhja e këtij Komisioni bëhet jo më vonë se dy javë nga data e njoftimit të ri.

3. Anëtarët e Komisionit Kombëtar kundër Dhunës në Sport përfitojnë për pjesëmarrje, në çdo mbledhje, një shpërblim prej 5 000 (pesë mijë) lekësh.

4. Pagesat për shpërblimet të përballohen nga të ardhurat dytësore, miratuar për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve (Fondi Kombëtar i Zhvillimit të Sportit).

5. Ngarkohet Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 20, datë 13.1.2006

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.726, DATË 23.11.2005 “PËR SHPRONËSIMIN
PËR INTERES PUBLIK TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË
PRIVATE, TË CILAT PREKEN NGA NDËRTIMI I SEGMENTIT RRUGOR QAFË-
KASHAR-RINAS”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Pika 6 e vendimit nr.726, datë 23.11.2005 të Këshillit të Ministrave ndryshohet, si më poshtë vijon:

“6. Shpronësimi të përfundojë brenda datës 31.3.2006”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr. 1, datë 16.1.2006

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Gjergj Sauli	Kryetar i	Gjykatës Kushtetuese
Fehmi Abdiu	Anëtar i	“ “
Kujtim Puto	Anëtar i	“ “
Vjollca Meçaj	Anëtare e	“ “
Xhezair Zaganjori	Anëtar i	“ “
Petrit Piloçi	Anëtar i	“ “
Sokol Sadushi	Anëtar i	“ “
Kristofor Peçi	Anëtar i	“ “

me sekretare Arbenka Lalica, në datat 13.05.2005 dhe 14.06.2005, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen nr.29 Akti, që i përket:

KËRKUES: KRISTO LEPURI, përfaqësuar nga avokat Arben Hakani, me prokurë.

SUBJEKTE TË INTERESUARA:

1. JANULLA RRAPI, përfaqësuar nga avokat Agim Dishnica, me deklaram.
2. IVO LEPURI, përfaqësuar nga avokat Verdi Hadëri, me prokurë.
3. ALQI E POLIZOI LEPURI në mungesë.
4. AVOKATURA E SHTETIT në mungesë.
5. ZYRA E REGJISTRIMIT TË PASURIVE TE PALUAJTSHME SARANDË, në mungesë.
6. NDËRMARRJA KOMUNALE BANESA SARANDË, në mungesë.
7. BASHKIA SARANDË, në mungesë.

8. DEGA RAJONALE E ENTIT TË BANESAVE GJIROKASTËR, në mungesë.

9. KOMISIONI I KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE SARANDË, në mungesë.

OBJEKTI: Shfuqizimi si i papajtueshëm me Kushtetutën i vendimeve nr.1104, datë 19.09.2003 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë; nr.186, datë 04.05.2004 të Gjykatës së Apelit Gjirokastër dhe nr.2142, datë 24.12.2004 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 43, 131/f e 134/g të Kushtetutës, si dhe neni 6 i Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut.

Për të argumentuar karakterin antikushtetues të vendimeve të mësipërme, kërkuesi ka parashtruar këto shkaqe:

- Gjykimi i çështjes në shkallë të parë është bërë nga një gjyqtar pa u shqyrtuar vlera e padisë, duke shkelur kështu një prej elementeve esenciale të procesit të rregullt ligjor, që ka të bëjë me gjykatën kompetente të caktuar me ligj.

- Nga gjykata është shkelur parimi i barazisë së armëve, sepse paditësi apo i padituri asnjëherë nuk është i njëjtë me personin e tretë në aspektin e garantimit të tagrave. Në këtë rast, mosformimi i drejtë i ndërgjyqësisë e bën procesin të parregullt.

- Gjykata, me vendim të ndërmjetëm, nuk pranoi kundërpadinë, duke shkelur kërkesat e nenit 160 të Kodit të Procedurës Civile, që e detyron të shprehet për këtë vetëm me vendim përfundimtar.

- Gjykata e Apelit Gjirokastër nuk mori parasysh kërkesën për përjashtimin e trupit gjykues.

- Gjykata e apelit ka caktuar ekspertë pa marrë mendimin e palëve në gjykim dhe në kundërshtim me ligjin.

- Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhej ta kishte kaluar çështjen për shqyrtim gjyqësor, sepse rekursi i paraqitur përmbante shkaqe ligjore.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Kristofor Peçi, përfaqësuesit e kërkuesit, të subjekteve të interesuara dhe bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë, me vendimin nr.1104, datë 19.09.2003, ka vendosur pranimin e padisë së paditëses Janulla Rrapi (Lepuri) për ndryshimin e vendimit të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, duke u kthyer në natyrë sipërfaqen e truallit 215 m² trashëgimtarëve ligjorë të Marko Lepurit; dhënien e së drejtës së parablerjes të një objekti trekatësh të ndodhur në sipërfaqen 125 m²; kompensimin në natyrë të sipërfaqes 185 m²; konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike të kontratave të privatizimit të datave 09.11.1998 dhe 27 e 28.04.1999 dhe fshirjen e tyre nga hipoteka.

Gjykata e Apelit Gjirokastër, me vendimin nr.186, datë 04.05.2004, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së rrethit gjyqësor, pranimin e pjeshëm të padisë, lënien në fuqi të vendimit përse i përket pavlefshmërisë së kontratave, fshirjen e tyre nga hipoteka, si dhe dhënien e së drejtës së parablerjes të objektit dykatësh të ndërtuar mbi truallin njohur paditëses Janulla Rrapi.

Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë (dhoma e këshillimit) ka konstatuar se rekursi i paraqitur nga kërkuesi nuk përmban shkaqe nga ato që parashikon neni 472 i Kodit të Procedurës Civile dhe me vendimin nr.2142, datë 24.12.2004, ka vendosur mospranimin e tij.

Kërkuesi Kristo Lepuri në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese pretendon se të trija vendimet e gjykatave janë rezultat i një procesi të parregullt ligjor në referim të neneve 42 dhe 131/f të Kushtetutës dhe nenit 6 të Konventës Europiane për të Drejtat e Njeriut, për arsye se janë kryer shkelje të rënda procedurale, që kanë të bëjnë me gjykatën kompetente, barazinë e palëve në gjykim, paanësinë e gjykatës, respektimin e garancive procedurale dhe të standardeve kushtetuese.

Gjykata Kushtetuese vlerëson se problemet e ngritura nga kërkuesi janë objekt i shqyrtimit kushtetues, pasi kanë të bëjnë me pretendimin për cenimin e së drejtës kushtetuese për një proces të

rregullt ligjor. Në këto kushte, ajo i shqyrton pretendimet e kërkuarit duke i ballafaquar ato me kërkesat e standardet e procesit të rregullt në kuptimin kushtetues.

Në rastin konkret, pretendimi i kërkuarit se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Sarandë ka cenuar një element thelbësor kushtetues që lidhet me gjykatën kompetente, pasi e ka gjykuar çështjen me një gjyqtar pa përcaktuar më parë vlerën e padisë, nuk mund të merret në shqyrtim në aspektin e kontrollit kushtetues, sepse nuk është ngritur në asnjë shkallë të gjyqimit. Nga aktet nuk rezulton që palët e interesuara në gjykim ta kenë ngritur një pretendim të tillë në gjykatën e shkallës së parë dhe as në atë të apelit. Në rekursin drejtuar Gjykatës së Lartë përmendet fakti që gjykimi është bërë nga një gjyqtar, por nuk është kërkuar që çështja të gjykohet me trup gjykues duke përcaktuar edhe vlerën e padisë.

Lidhur me këtë, Gjykata Kushtetuese konfirmon qëndrimin e saj të mbajtur në vendimet e mëparshme se shkelja e të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor mund të pretendohet në këtë Gjykatë vetëm pas ezaurimit të të gjitha mundësive që ofron sistemi i padive dhe i apelimëve.¹ Mbrojtja kushtetuese për një proces të rregullt ligjor, nënkupton edhe konsumimin, si rregull, para gjykatave të sistemit gjyqësor të çdo pretendimi ligjor që parashikohet si shkak shfuqizimi në kërkesën drejtuar Gjykatës Kushtetuese.² Prandaj ky pretendim i ngritur nga kërkuari në Gjykatën Kushtetuese, mbi përbërjen e trupit gjykues, nuk mund të shërbejë si shkak për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore.

Barazia e palëve në gjykim, që përbën një pretendim tjetër të kërkuarit, është një nga kërkesat e rëndësishme të procesit të rregullt ligjor. Gjykata Kushtetuese në vendimet e saj, duke u mbështetur edhe në praktikën e Gjykatës Europiane për të Drejtat e Njeriut, ka argumentuar domosdoshmërinë e zbatimit të këtij parimi në gjykimin e çështjeve, duke theksuar se njëra palë nuk duhet të vihet në pozita haptazi të pabarabarta me palën tjetër, gjë që do të cenonte thelbin e procesit të rregullt ligjor. Duke krahasuar këto parime e standarde, që lidhen me barazinë e palëve në proces, me pretendimet e ngritura nga kërkuari, Gjykata Kushtetuese vëren se këto të fundit janë të pabazuara dhe nuk mund të pranohen si shkaqe që e bëjnë procesin gjyqësor të parregullt. Konkretisht, kërkuari pretendon se duhej të ishte thirrur në gjykim me cilësinë e të paditurit dhe jo të personit të tretë dhe në këtë mënyrë, është vënë në një pozitë të pabarabartë, pra është shkelur parimi i barazisë së armëve. Pavarësisht nga ky pretendim i kërkuarit, në rastin konkret, procesi nuk mund të konsiderohet i parregullt, sepse palët kanë marrë pjesë në gjykim dhe kanë realizuar të drejtat procedurale të garantuara sipas ligjit.

Edhe pretendimi tjetër i kërkuarit se gjykata e shkallës së parë i ka mohuar ushtrimin e një mjeti procedural të ligjshëm, pasi me vendim të ndërmjetëm nuk i ka pranuar kundërpadinë, nuk e bën procesin të parregullt në kuptimin kushtetues. Kërkuari ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes duke shprehur pa asnjë kufizim pretendimet e prapësimet e tij, të cilat janë vlerësuar nga gjykata.

Në lidhje me shkaqet që evidentojnë shkeljet e ligjit nga gjykata e apelit, të ngritura në kërkesë, Gjykata Kushtetuese vlerëson se shkeljet e pretenduara gjithashtu nuk qëndrojnë dhe për pasojë, nuk ka cenim të procesit ligjor. Kështu, kërkuari pretendon se gjykata e apelit ka vazhduar gjykimin e çështjes edhe pse u kërkua përjashtimi i trupit gjykues për kushtet e njëanshmërisë në gjykim, sipas nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Por, në kundërshtim nga sa pretendon kërkuari, anëtarët e trupit gjykues kanë marrë pjesë më parë në një çështje tjetër, ku ndryshon objekti dhe palët. Në këto rrethana, ata nuk kishin pengesë ligjore që, në kuptim të nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile, të merrnin pjesë në gjykimin e çështjes konkrete.

I pabazuar është edhe pretendimi tjetër për caktim të ekspertëve nga gjykata e apelit. Është e drejtë dhe detyrë e gjykatës të caktojë ekspertë sipas rregullave të Kodit të Procedurës Civile, kur për sqarimin e fakteve që kanë lidhje me mosmarrëveshjen në gjykim, kërkohen njohuri të posaçme. Pretendimi i kërkuarit se në këtë rast gjykata nuk ka zbatuar rregullat procedurale vjen në kundërshtim me të dhënat e dosjes, në të cilën evidentohet se për caktimin e ekspertëve ka vendim të ndërmjetëm, i cili u është komunikuar palëve dhe se ata janë betuar sipas ligjit.

Është i pasaktë edhe pretendimi që bën kërkuari, sipas të cilit Gjykata e Lartë ka përdorur

¹ Vendim nr.10, datë 02.04.2003 i Gjykatës Kushtetuese

² Vendimet nr.9 e 10, date 09.05.2005 të Gjykatës Kushtetuese

standarde të ndryshme, sepse çështjet që krahasohen janë të ndryshme.

Në këto rrethana, kur asnjë nga pretendimet e kërkuarit nuk përbën shkak ligjor, nuk qëndron as pretendimi i tij se Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë duhej ta kalonte çështjen në seancë. Përderisa Kolegji Civil ka vlerësuar se rekursi nuk përmban shkaqe nga ato të parashikuara në nenin 472 të Kodit të Procedurës Civile, me të drejtë ka vendosur mospranimin e tij në dhomën e këshillimit.

Përfundimisht, Gjykata Kushtetuese çmon se pretendimet e kërkuarit Kristo Lepuri, për shkelje të të drejtave kushtetuese për një proces të rregullt ligjor nga gjykatat e sistemit gjyqësor, janë të pabazuara, prandaj kërkesa e tij duhet të rrëzohet.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, mbështetur në nenet 42 e 131/f të Kushtetutës, si dhe në nenin 72 të ligjit nr.8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, me shumicë votash,

VENDOSI:

- Rrëzimin e kërkesës.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

MENDIMI I PAKICËS

Për mënyrën e arsytimit të vendimit, si dhe të zgjidhjes që i është dhënë çështjes, pakica mban një qëndrim të kundërt me shumicën.

Kërkuari ka vënë për diskutim përpara Gjykatës Kushtetuese disa pretendime për cenimin që i është bërë së drejtës së tij për një proces të rregullt ligjor, të cilat nuk janë pranuar nga shumica në vendimin e saj. Kërkuari ka argumentuar se në të gjitha instancat e gjykimit janë shkelur parime të rëndësishme kushtetuese, që lidhen me aksesin në gjykatë, me barazinë e mjeteve në proces, si dhe me parimin e paanësisë.

Pakica ka mendimin se këto parime kushtetuese, të cilat konsiderohen si pjesë e së drejtës për një proces të rregullt ligjor, janë shkelur në mënyrë të veçantë nga gjykata e shkallës së parë dhe ajo e apelit.

Konkretisht, çështja ka pasur për objekt gjykimi ndryshimin e vendimit të komisionit të kthimit të pronave, si dhe pavlefshmërinë e kontratës së shitjes. Gjykata e shkallës së parë ka deklaruar të pavlefshme kontratën e shitjes të lidhur në emër të kërkuarit, ndërkohë që nuk e ka thirrur atë në gjykim me cilësinë e të paditurit. Për këtë arsye, kërkuari që në fillim të procesit ka kërkuar që të mos thirrej me cilësinë e personit të tretë, por me cilësinë e të paditurit në gjykim. Duke qenë se paditësi kundërshtonte në padi pronësinë e kërkuarit, ky i fundit i është drejtuar gjykatës me kundërpadi për anulimin e vendimit të komisionit të kthimit të pronave. Gjykata e ka rrëzuar me vendim të ndërmjetëm këtë kërkesë dhe e ka përfunduar gjykimin në disfavor të kërkuarit. Me këtë zgjidhje që ka bërë gjykata, e ka zhveshur kërkuarin nga e drejta e pronësisë, duke e deklaruar të pavlefshme kontratën e tij të shitblerjes, pa e thirrur si të paditur në gjykim.

Mosvendosja e kërkuarit në pozitën procedurale të të paditurit, ndërkohë që kundërshtoihej pronësia e tij, mosmarrja në shqyrtim e kundërpadisë së paraqitur prej tij, që, sipas rrethanave të çështjes, rezultonte se kishte lidhje me atë të padisë, si dhe mosdhënia e arsyeve ligjore për refuzimin e kundërpadisë në vendimin përfundimtar të gjykatës së shkallës së parë, i kanë hequr kërkuarit të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, si dhe e kanë vendosur atë në një pozitë të pabarabartë në raport me paditësin në proces.

Gjykata e shkallës së parë nuk i ka dhënë mundësi kërkuarit që të përdorë lirisht mjetet e tij ligjore për të pasur një proces gjyqësor të rregullt nga pikëpamja kushtetuese. Një qëndrim i tillë ka cenuar kërkesat e nenit 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe të nenit 6 të Konventës

Europiane për të Drejtat e Njeriut. Veprime të tilla flagrante të shkeljes së ligjit dhe të së drejtës për një proces të rregullt ligjor nuk janë vlerësuar të tilla nga shumica në vendimin e saj.

Parregullsia e procesit ligjor konstatohet edhe në cenimin e parimit të gjykimit nga një gjykatë e paanshme. Në gjykimin në shkallë të dytë kanë marrë pjesë tre gjyqtarë, të cilët kishin shfaqur mendim për pronësinë e kërkuarit në gjykime të tjera. Konkretisht, të tre anëtarët e trupit gjykues (njëri si gjyqtar i shkallës së parë dhe dy të tjerë si gjyqtarë të apelit) kishin shfaqur mendim për të njëjtën pronë, me të njëjtat palë, por me objekt padie të ndryshme. Të tre këta gjyqtarë në gjykimin e mëparshëm janë shprehur në disfavor të kërkuarit, Kristo Lepuri. Janë të tre këta gjyqtarë që këtë radhë në pozitën e gjyqtarëve të apelit shfaqin të njëjtin mendim për kërkuarin. Duke qenë se, te kërkuari, prania në këtë trup gjykues e tre gjyqtarëve që ishin shprehur më parë në disfavor të tij e krijonte dyshimin e arsyeshem se ata nuk do të ishin të paanshëm në gjykim, ka kërkuar përjashtimin e tyre nga shqyrtimi i mëtejshëm i çështjes, kërkesë e cila nuk është pranuar.

Kjo është një rrethanë që duhej vlerësuar nga shumica si objektivist e justifikueshme për ta konsideruar gjykatën si të njëanshme në zgjidhjen e çështjes.

Argumenti që përdor shumica për rrëzimin e këtij pretendimi të kërkuarit, bazohet në faktin se nuk është e njëjta çështje dhe për rrjedhojë nuk shkelen kërkesat e nenit 72 të Kodit të Procedurës Civile. Pakica ka mendimin e kundërt se neni 72 i Kodit të Procedurës Civile nuk e trajton shkeljen e parimit të paanësisë vetëm në shfaqjen e mendimit për të njëjtën çështje, siç arsyetohet shumica, dhe nuk e lidh me qenien ose jo përpara gjësë së gjykuar. Arsyet serioze të njëanshmërisë që objektivist ekzistojnë te gjykata, janë pjesë përbërëse e evidentimit të shkeljes së këtij parimi kushtetues. Detyrë e gjykatës në çdo proces gjyqësor është që të mundësojë krijimin e besimit se ajo do të shfaqet si e paanshme në zgjidhjen e çështjes. Gjykimi i çështjes midis palëve të njëjta dhe për të njëjtin objekt fizik, për të cilin gjyqtarët më parë kishin shfaqur mendimin në disfavor të kërkuarit, ka qenë një arsye e përligjur për konstatimin e cenimit të parimit të paanësisë në kuptim të së drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Ky qëndrim që mban pakica në mendimin e saj është në të njëjtën linjë arsyetimi me praktikën e konsoliduar në vazhdimësi të Gjykatës Kushtetuese, e cila është devijuar nga shumica, për rastin në shqyrtim.

Anëtar: K. Peçi, S. Sadushi, F. Abdiu

VENDIM

Nr. 1, datë 11.1.2006

PËR TRANSFERIMIN E LICENCËS NGA SHOQËRIA “KORSEL“ SHPK TE SHOQËRIA “MAKSI ELEKTRIK” SHPK

Në mbështetje të neneve 9 dhe 20, pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe pikës 1.4 “Kushtet e licencës për prodhimin e energjisë elektrike nga centralet elektrike ekzistuese me kapacitet të përgjithshëm jo më të madh se 5 MW”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.01.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga shoqëria “Korsel” sh.p.k., për transferimin e licencës nga shoqëria “Korsel” sh.p.k., te shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k., për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike në Hidrocentralet Leskovik 1 dhe 2 të rrethit të Korçës,

VENDOSI:

1. Transferimin e licencës për aktivitetin e prodhimit të energjisë elektrike, nga shoqëria “Korsel” sh.p.k., te shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k.
2. Miratimin e transferimit të aseteve të shoqërisë “Korsel” sh.p.k., te shoqëria “Maksi Elektrik” sh.p.k. me të njëjtën vlerë aseti.
3. Shfuqizimin e vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr.12, datë 7.04.2004, “Për

licencimin e shoqërisë “Korsel” sh.p.k., për prodhimin e energjisë elektrike për hidrocentralet Leskovik 1 dhe 2 të rrethit të Korçës”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr. 2, datë 11.1.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të nenit 9 dhe nenit 13, pika 1 germa b të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.26, datë 13.05.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” neni 11 germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.01.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “OST” sh.a. për t’u licencuar për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë “OST” sh.a., për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënive me Publikun, për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e procedurave, sipas “Rregullores për procedurat e licencimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr. 3, datë 11.1.2006

PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHQYRTIMIT

Në mbështetje të neneve 9 dhe 13, pika 1 gjerat a, c, ç, d, dh të ligjit nr.9072, datë 22.05.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të vendimit të Bordit të Komisionerëve nr. 26, datë 13.05.2004 “Për miratimin e rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s,” neni 11, germa A, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.01.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë “KESH” sh.a., për t’u licencuar për aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit, eksportit dhe importit të energjisë elektrike,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e kërkesës për licencimin e shoqërisë “KESH” sh.a., për aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit, eksportit dhe importit të energjisë elektrike.

2. Ngarkohet Departamenti i Licencimit dhe Monitorimit, si dhe Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënive me Publikun, për zbatimin e këtij vendimi dhe ndjekjen e procedurave, sipas “Rregullores për procedurat e licencimit”.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

Fletorja Zyrtare gjendet:

- duke u abonuar pranë njërive postare të qyteteve ose
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare; në adresën:
Bulevardi Zhan d'Ark, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot" Tel: 042 555 63; 267 468

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

**REGJISTRAT E NOTERISË SIPAS FORMATIT TË MIRATUAR
NGA MINISTERIA E DREJTËSISË 2005**

1. REGJISTRI I PËRGJITHSHËM I AKTEVE DHE I VEPRIMEVE NOTERIALE	1000
2. REGJISTRI I TESTAMENTEVE	500
3. REGJISTRI I DEPOZITIMIT TË PARAVE OSE VLERAVE TË TJERA	500
4. INDEKSI ALFABETIK	600

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI

1. PËR PROKURIMIN PUBLIK.....	1500
2. PËR NËPUNËSIN CIVIL (Botim, 2005)	600
3. PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim I-rë).....	1500
4. PËR TAKSAT DHE TATIMET.....	1500
1. TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004 ...	1500
2. TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-Korrik 2004.....	2000

BOTIME TË REJA

1. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË (Vëllim i II-të)	1500
2. KODI DOGANOR.....	1000
3. KODI DETAR	1000

Doli nga shtypi më 24.1.2006

Tirazhi: 4000 copë

Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2006

Çmimi: 150 lekë